

Pytje ne rrjeta...

1. Ekzistojnë tri kategori të Listave të Kontrollit të Qasjes e ato janë:

- IP Listat e Kontrollit të Qasjes Standarde
- IP Listat e Kontrollit të Qasjes të Zgjeruara
- IP Listat e Kontrollit të Qasjes me emërtim

2. Qka jane ACL?

ACL-të na japin mundësi të kufizojmë trafikun në rrjetë, të rrisim performance dhe të menaxhojmë sigurinë në rrjetë.

3. Topologjia fizike është shtrirja fizike e komponentëve në një rrjetë kompjuterike

4. Topologjia logjike përcakton si hostet qasen në medium që të komunikojnë në rrjetën kompjuterike

5. Ekzistojnë pesë topologjitë fizike të rrjetave kompjuterike:

- Topologjia magjistralë
- Topologjia unazë
- Topologjia yll
- Topologjia mesh.
- Topologjia hierarkike apo ylli I zgjeruar

6. Rrjeta Lokale LAN (ang.Local Area Network)-është një rrjetë për transmetimin e të dhënave me shpejtësi të madhe dhe që mbulon hapësira relativisht të vogla gjeografike.

7. Komponentat e Rrjetave locale LAN:

- Kompjuterët
- Kartelate rrjetave-NIC
- Pajisjet periferike
- Mediumet të rrjetave
- Pajisje te ndryshme të rrjetave

8. Rrjetat e gjëra WAN (ang.Wide Area Networks)–bën ndërlidhjen e rrjetave locale, LAN, dhe I ofron qasje për kompjuter apo fajl-server në lokacione të largëta.

9. Teknologji që përdoren në rrjetat WAN:

- Modem
- Rrjetat e shërbimeve të integruara digjitale ISDN (ang.Integrated Services Digital Networks)
- Rrjetat digjitale të pajtimtarëve DSL (ang.Digital Subscriber Line)
- Rrjetat T1,T3,E1,E3
- Rrjetat Optike Sincrone–SONET (ang.Synchronous Optical Networks)

10. Rrjetat Metropolitane MAN (ang.Metropolitan Area Network) –zakonisht përbëhen nga dy apo më tepër rrjeta locale LAN që ndodhen në një qytet.

11. Rrjetat klient-server–Në këto rrjeta klienti kërkon informata apo shërbime nga serveri, ndërsa serveri ofron shërbime apo informatat e kërkuara.

12. Rrjetat e hapësirave për ruajtjen e të dhënave SAN (ang.Storage Area Networks)–janë rrjeta të dedikuara me performacë të lartë që përdoret për të zhvendosur të dhënat nga Server në pajisje të specializuara për ruajtjen e të dhënave.

13. Rrjetat SAN ofrojnë këto mundësi:

–Performancë–mundësojnë qasje në kohë reale dhe me shpejtësi të madhe në matrica të disqeve apo kasetave.

–Disponueshmëri–mund të bëjnë kopje të të dhënave në rrjeta tjera SAN, dhe atë deri në 10 km distancë.

–Shkallëzim–me lehtësi mundësojnë bartjen e të dhënave, migrimin e të dhënave dhe replikimin e të dhënave në mes të sistemeve të ndryshme.

14. Rrjeta private virtuale (VPN) është një rrjet private e cila përdorë rrjetën publike siç është interneti për të lidhur lokacionet e largëta apo shfrytëzuesit

15. Bandwidthin e përkufizojmë si sasi e informatave që mund të kalojë nëpër linjat komunikuese të rrjetës në një periudhë të caktuar kohore.

16. Procesi i cili mundëson bartjen e paketave të të dhënave ndërmjet LAN-eve të ndryshëm, dhe i cili cakton rrugën më të mire që paketat duhet ta kalojnë nga burimi deri tek destinacioni quhet procesi i rrugëtimit

17. Disa nga llojet e të dhënave që mund të ndodhen në tabelën e rrugëtimit janë:

–Rrugët statike

–Rrugët e parazgjedhura

–Rrugët dinamike

18. Disa nga veçoritë kryesore të protokollit RIPv2 që kanë të bëjnë me parandalimin e unazave të rrugëtimit janë:

–Numërim në pafundësi (ang.Count to infinity)

–Horizonti i ndarë(ang.split horizon)

–Afati kohor i pritjes

–Përditësimet e nxitura

–Balancimi i ngarkesës

19. EIGRP i përdor 5 lloje të paketave për funksionim normal:

- Paketa hello
- Paketa e konfirmimit
- Paketat e përditësimit
- Paketat e pyetësorit dhe përgjigjeve

20. Disa nga karakteristikat e EIGRP-së janë:

- Konvergjencë më të shpejtë dhe përdorim më të vogël të bandwidthit
- Mbështetje për VLSM
- Mbështetje e shumëfishtë për protokolle të rrugëtuar

21. Algoritmi DUAL (ang.Diffusing Update Algorithm) është component qendrore llogaritëse e protokollit EIGRP

22. Disa nga veçoritë kryesore të OSPF:

- Konvergjencë e shpejtë
- Përkrahje për VLSM, supernetting dhe përmbledhje
- Përkrahja për rrjeta të mëdha
- Bartja efikase dhe e besueshme e përditësimeve të rrugëtimit
- Balancimi i rrugëve të shumëfishta

23. Ekzistojnë dy lloje të algoritmeve të rrugëtimit që përdoren nga protokollet IGP e ato janë:

- Algoritmi Vektorë Distance (ang.Distance Vector)
- Algoritmi i Gjendjes së Linkut (ang.Link State)

24. Vargu i adresave të brendshme(Private IP)




- A - 10.0.0.0 deri 10.255.255.255
- B - 172.16.0.0 deri 172.31.255.255
- C - 192.168.0.0 deri 192.168.255.255

25. NAT është proces i përkthimit të një IP adrese të brendshme (private) me një adresë publike.

26. Tre forma të NAT

- NAT Statik
- NAT Dinamik
- NAT i tejngarkuar (PAT)

27. IP Ver 6?

Tipi i adresës	Përshkrimi	Topologji
Unicast	<p><i>“Një me Një”</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Adresa e destinuar për një ndërfaqe të vetëme. Paketa e dërguar në adresën unicast dorëzohet tek ndërfaqe që identifikohet me atë adresë 	
Multicast	<p><i>“Një me Shumë”</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Adresa për një grup të ndërfaqeve (zakonisht i përket hosteve të ndryshëm). Paketa e dërguar në adresën multicast do tu dorëzohet të gjitha ndërfaqeve të identifikuara nga ajo adresë. 	
Anycast	<p><i>“Një me më të afërt”</i> (e alokuar nga Unicast)</p> <ul style="list-style-type: none"> Një adresë për një grup të ndërfaqeve. Në shumocën e rasteve këto ndërfaqe i takojnë ndërfaqeve të ndryshme. Paketa e dërguar në adresën anycast dërgohet tek ndërfaqe më e afërt e përcaktuar nga IGP. 	

28. IP adresa është një adresë logjike e protokollit IP, që vepron në shtresën e Rrjetave të modelit OSI

29. Procesi I ndarjes logjike të rrjetave fizike të klasave A, B dhe C në rrjeta më të vogla quhet procesi I subnetimit.

30. Procesi I krijimit të subnetave me gjatësi variabile të subnet maskave brenda një rrjete quhet procesi VLSM.

31. Suiçi është pajisje e specializuar e rrjetave kompjuterike që vepron në shtresën e dytë të modelit OSI

32. Suiçi në LAN mundëson që shumë shfrytëzues të komunikojnë paralelisht duke shfrytëzuar qarqet virtuale dhe mikro-segmente

33. Varësisht nga kapaciteti I bandwidthit të porteve suiçi përdor dy mënyra për t’I transmetuar kornizat:

- Komutim Simetrik
- Komutim Asimetrik

34. Memoria buffer përdor dy metoda për pëcjellje të kornizës:

- memorie ebuferit e bazuar në porte
- memorie ebuferit e bashkëndarë

35. Rrjetat Lokale Virtuale(VLAN) janë grupime logjike të pajisjeve apo përdoruesve sipas funksionit, departamentit apo aplikacioneve.


36. Veçorit kryesore të Suiçit në LAN janë:

- E izolon trafikun në mes të segmenteve
- Arrinë kapacitet më të madh të bandwidthit për përdorues duke krijuar domain më të vogël kolizionit.


37. Memoria buffer përdor dy metoda për pëcjellje të kornizës:

- memorie e buferit e bazuar në porte
- memorie e buferit e bashkëndarë

38. Shtresat e modelit OSI




39. Shtresat e modelit TCP/IP



40. Protokollet që veprojnë në shtresën e Aplikacionit të modelit TCP/IP janë:

- Protokolli DNS (ang.Domain Name Service)
- Protokolli HTTP (ang.Hypertext Transfer Protocol)
- Protokolli SMTP (ang.Simple Mail Transfer Protocol)
- Protokolli FTP (ang.File Transfer Protocol)
- Protokolli Telnet

41. Numrat e porteve:



42. Enkapsulimi është një process gjatë së cilit të dhënat mbështillen me headerin e një protokollit të caktuar para se paketa të transmetohet nëpër rrjetë.

43. Ruteri është pajisje që vepron në shtresën e tretë të modelit OSI, ndërlidhë dy apo më tepër rrjeta dhe gjen rrugën më të mirë për transmetimin e paketave

44. Funkcionet themelore të ruterit janë:

- Caktimi i shtegut më të mirë
- Komutimi i paketave
- Ndërlidhja fizike
- Ndërlidhja logjike
- Kalkulimi dhe mirëmbajtja e rrugëve

45. Ruterët të cilët gjatë punës së tyre bëjnë grumbullimin dhe shpërndarjen e informatave të rrugëtimit brenda domenit të tyre ndryshe quhen edhe ruterë të brendshëm apo interiorë.

46. Ruterët të cilët gjatë punës së tyre bëjnë grumbullimin dhe shpërndarjen e informatave të rrugëtimit për rrjetat që gjenden jashtë sistemit autonom të tyre quhen ruterë të jashtëm apo eksteriorë.

47. Ruterë që mundësojnë ndërlidhjen e sistemit autonomy me internet apo ndonjë rrjet privat quhen ruter kufitar.

48. Modeli Hierarkik tre shtresor:

